VENDIM
Nr.641, datë 24.12.1999

PËR AKORDIM FONDI PËR FINANCIMIN E BLERJES SË OBJEKTIT NGA FRROK GJINI PËR TREGUN E QYTETIT TË VAUT TË DEJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë" me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Bashkisë Vau i Dejës, në buxhetin e vitit 1999, t'i shtohet një fond prej 6.3 milionë lekë për blerjen e objektit, nga Frrok Gjini, për tregun e qytetit.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Financave dhe Bashkia Vau i Dejës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta